



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 39 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 4248 prot., datë 06.09.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Me vendimet 437-468, datë 31.07.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor magistratët e diplomuar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2024, janë emëruar gjyqtar dhe aktualisht po vijohet me procedurën për caktimin e tyre në pozicion në gjykatat respektive.

Në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 38 dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 114, datë 09.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve“ ka miratuar rregulla të detajuara mbi procesin e krijimit dhe administrimit të dosjeve personale dhe regjistrit të magistratëve (gjyqtar) pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si bazë unike e të dhënave profesionale dhe personale të gjyqtarëve, që plotësohet mbi bazën e dosjes personale të çdo magistrati (gjyqtar).

Në kushtet kur, 32 magistratët aktual nuk janë caktuar ende në pozicion në gjykatat respektive, informacioni mbi “Të dhënat e magistratëve në sistemin gjyqësor” në regjistrin elektronik të magistratëve nuk mund të gjenerohen, deri në caktimin e gjykatës ku magistratët do të ushtrjnë funksionin.

Për sa më sipër, në kushtet kur procedura për caktimin në pozicion të 32 magistratëve po vijon me ritme të shpejta, Këshilli i Lartë Gjyqësor do tju përcjellë informacionin e kërkuar nga ana juaj, sapo magistratët të caktohen në pozicion.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!